



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/1278**  
**Data e Vendimit: 14.01.2026**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Cocrra” SH.P.K kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “168 Paisje IT-Tabela Digjitale -Ritender” me numër të prokurimit 616-25-10698-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 14.01.2026, mori këtë

## **Vendim**

**I. Hedhet si jo e plotë**, ankesa e OE “Cocrra” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/1278, e datës 27.12.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “168 Paisje IT-Tabela Digjitale -Ritender” me numër të prokurimit 616-25-10698-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

**II.** I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “168 Paisje IT-Tabela Digjitale -Ritender” me numër të prokurimit 616-25-10698-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

**III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 27.12.2025, ka pranuar ankesën e OE “Cocrra” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “168 Paisje IT-Tabela Digjitale -Ritender” me numër të prokurimit 616-25-10698-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

Nga provat e administruara OSHP konstaton se me datën 24.11.2025, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë (B05).

Me datën 12.12.2025, OE “Cocrra” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK, të cilën AK e ka refuzuar me datën 18.12.2025.

Kundër vendimit të AK-së me datën 27.12.2025, OE “Cocrra” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/1278 (Nr. protokolli)

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, është konstatuar se operatori ekonomik ankues nuk ka dorëzuar dëshmi të plotë bankare për pagesë (nuk ka kryer pagesë sipas vleres së perlllogaritur ) siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores për Prokurim Publik 002/2024 (versioni i konsoliduar) si dhe nenin 118 të LPP-se.

**Ankuesi me dt. 05/01/2026 përmes e-mailit zyrtar të OSHP-së është njoftuar për plotësim të pagesës së tarifës për ankesën, mirëpo i njëjti nuk është përgjigjur njoftimit pasi që vlera e parashikuar ka qenë 610,000.00 Euro, ndërsa shuma e depozitës 5,000.00 Euro.**

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas të gjitha fakteve të analizuar sqaron se sipas nenit 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji si dhe nenin 69.2 të rregullores nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik (Versioni i Konsoliduar) ku thuhet: 69.2 Në përputhje me nenin 118 të LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 200 Euro dhe jo më shumë se 10, 000 Euro. Në rast të aktiviteteve të prokurimit të ndare në LOT (Pjesë), Operatori ekonomik ankues duhet të përcaktohet për cilin LOT (Pjesë) parashtron ankese, Shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar për Lot, por jo më pak se 200 Euro dhe jo më shumë se 10, 000 Euro

Poashtu sipas nenit 118 paragrafi 2 i LPP-së thuhet: 2. *OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet”.*

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së me saktësisht nenin 118 par 1 dhe 2 te LPP-se si dhe nenin 69 par 2 te Rregullores për Prokurim Publik 002/2024, andaj mbi bazën e këtyre dispozitave ankesa

e OE “Cocrra” SH.P.K hedhet poshtë si jo e plotë (nuk shqyrtohet) dhe i lejohet autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “168 Paisje IT-Tabela Digjitale -Ritender” me numër të prokurimit 616-25-10698-1-1-1 përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqësi i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Cocrra SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: